

SERVETE DERGUTI

VEÇORITË MORFO-STRUKTURE E FJALËFORMUESE TË LEKSIKUT TË SHQIPES NË “FJALORTHIN E RI” TË NIKOLLË GAZULLIT

Sapo të hapësh faqet e para të “Fjalorthit të Ri” të Nikollë Gazullit, në parathënien e këtij fjalorthi, ndeshesh me citimin: – “*U bânë hulumtime..., për arsye se fjalori i vogël u paraqitet të dijshëmvet shqiptarë e të huej për studim, e don me kjenë një pasqyrë, si do të studjohen djalektat e ndryshëm, për me i a mbërrî një fjalori të madh të përbashkët*”. Autori vijon më tutje: – “*Në krye të fjalorit po vë edhe një studim të nevojshëm mbi parashtesa e mbrapashtesa të gjuhës qi kâ me vjeftë si çilës për me kuptue lehtazi ndërtimin e gjuhës: po qes si pasqyrë fjalën: bazhgare (SHK. SP. e njeti) për me dijtë se kah vjen të marrim fjalën: bagjë (sh. Fjalorin) së cillës tue i shtue mbrapashtesat: k (sh. Pjerk, shularkë etj.) + are (shqip-t-are) na del fjala bazhgare. Don me dijtë se gj në gjuhën shqipe shëndrohet shumë herë në zh...*”

Vlerat e rralla të “Fjalorthit të Ri” të Gazullit, do të paraqiteshin në një formë të përkryer, sikurse nga rrallëkush deri më tani në fushën e gjuhësisë dhe të etimologjisë, nga dijetarët e mëdhenj, prof. Eqrem Çabej dhe prof. Aleksandër Xhuvani, në veprat e tyre madhështore, në bashkëpunim: “Parashtesat e gjuhës shqipe 1956” dhe “Prapashtesat e gjuhës shqipe 1962”, ku si ndajshesa u morën një sërë parashtesash e prapashtesash fjalëformuese nga fjalorthi i Gazullit, të cilat u studiuan dhe u analizuan në mënyrë të tërësishme dhe shërbyen si pikë referimi për këto studime. Ndërsa në veprat: “Etimologji e Gjuhës Shqipe I” dhe “Etimologji e Gjuhës Shqipe II” (“Etimologji e Gjuhës Shqipe”, botuar në 7 vëllime), botim i vitit 1976, prof. Eqrem, Çabej analizon një numër të konsiderueshëm fjalësh, ku fjalët e marra nga fjalorthi i Gazullit janë të pranishme thuajse në të gjitha faqet e dy veprave. Kjo ishte edhe arsyeja pse veprat nuk u botuan në rend kronologjik.

Po si paraqitet pasuria leksikore në fjalorthin me rreth 5000 fjalë e shprehje të Gazullit?

Nga ana e ndërtimeve morfo-strukture, pasuria e fjalorit ndahet në dy nëngrupe të mëdha:

- a. Në emërtime të thjeshta (njëfjalëshe).
- b. Në emërtime të pathjeshta (emërtime togfjalësh).

Në fjalorth shpjegohen bindshëm edhe mjaft rrënjë primitive, që në përdorimin e sotëm të gjuhës nuk jetojnë më. Studiuesi Simon Pepa shpjegon se: “Në shqipen e sotme përdoren dendur fjalët e prejardhura: *gjurmë, gjurmim, përkul, shkul, gërmuq, kalibobë* etj. por, askund nuk dalin rrënjët *gjur-, kul-, muq-, bobe-* etj. Gazulli, me intuitën gjuhësore që e karakterizon, jep rrënjët primitive: *gjur-as, “po gjurasim (po mbledhim) gështenja”*. Nga kjo, sipas tij, shpjegohen edhe *gjur-më e gjur-moj* etj.”¹

Emërtimet e thjeshta formojnë grupin kryesor në fjalorth, të cilat ndahen në dy nëngrupe të mëdha:

1.Fjalë të parme.

2.Fjalë jo të parme.

Fjalët e parme janë ato fjalë të pazbërthyeshme morfologjikisht dhe të pamotivueshme semantikisht, pra kuptimi i tyre nuk buron nga ndonjë temë tjetër, të cilat dalin si pjesë të ndryshueshme e të pandryshueshme të ligjëratës si²:

Emra: *aqçë, bënë* (për Veriun), *shullâ* (për Jugun), *bravë, dorë, orë, plis* etj.

Përemra: *Qit?* (për çfarë), *Kuj, Yejë* (për juaj) etj.

Mbiemra: *curi* (për njerëzit me veshë të vegjël), *lloçe* (për i/e zbutun), *thýçe* (për i/e brishtë), *akull, cale, cfetë* etj.

Folje: *blerë – blêrue, brî* (për brenë), *cî* (për lyp), *qasë, qepë, fytë* (për fut fillin në gjilpërë), *gjye, irë* (për zi, xi - nxin), *isht* (për është), *shâ, zie*, etj.

Ndajfolje: *ândë* (për nuk ma ka ënda), *brue, mat* (për ka ba shpija mat), *mekashna* (për nëmos), *mun* (për ndoshta), *tej, tek* etj.

Fjalët jo të parme janë të zbërthyeshme morfologjikisht dhe të motivueshme semantikisht. Ato paraqiten si tërësi të përbëra nga bashkime të ndryshme morfemash, rrënjësh, parashtesash e prapashtesash

¹ S. Pepa, *Dom Nikollë Gazulli dhe vepra e tij leksikografike*, në “Studime filologjike”, nr. 3-4, 1999, f. 103.

² *Gramatika e gjuhës shqipe 1*. Tiranë, 2002, f. 51.

fjalëformuese³, të cilat formojnë grupin më të madh të fjalëve në fjalorth dhe grupohen sipas mënyrave të fjalëformimit në:

Fjalë me prejardhje;
Fjalë të formuara me parashtesim;
Fjalë të formuara me prapashtesim;
Fjalë të formuara me parashtesim dhe prapashtesim;
Fjalë me përbërje;
Fjalë me përngjitje;
Fjalë me nyjëzim;
Fjalë me konversion.

Cila është risia që solli Gazulli nëpërmjet këtij fjalorthi?

Që nga faqja 17 – 41, në fjalorth gjejmë një numër tejet të lartë mjetesesh fjalëformuese me të cilat janë formuar një numër i madh fjalësh me prejardhje. Me rend alfabetik, Gazulli pasqyron në fjalor 67 prapashtesa fjalëformuese si:

bi: *bi-nak, bi-nosh, bi-gëzue* etj.;
ç: *ç-germue, ç-mbush, ç-ngulë, ç-rrethue* etj.;
mbë: *mbë-shtetsë, mbë-za* etj.;
ndën-nën: *ndën-kamcë, ndën-tashëm* etj.;
pa: *pa-anshëm, pa-giasë, pa-matun* etj.;
për: *për-buzët, për-mallim, për-ftue* etj.;
z: *z-bardhë, z-beh, z-bllokue, z-dritë* etj.

dhe 154 prapashtesa fjalëformuese, si dhe disa ndërrime ndërzanesh⁴, sikurse i emërtion autori. Fjalët e formuara me parashtesim, nuk janë të shumta në numër, ndërsa ndërtimet prapashtesore janë më të shumta dhe njihen edhe sot si më prodhimtare, si:

ac: *frik-ac, kop-ac* etj.;
aç-ë: *kungull-aç, lug-aç, idhn-aç, pjek-aç* etj.;
ak: *laur-ak, rreshp-ak, rruf-ak, rrumbull-ak* etj.;
an: *cur-an, kec-an, lara(m)-an, mërdhac-an*;
ash: *qerb-ash, mbrîj-ash* etj.;
çë: *fill-çë*;
esë: *emn-esë, germ-esë, lig-esë* etj.;
ik: *balt-ik, stërp-ik (pip lisi)* etj.;
man: *cuc-man, çakrra-man* etj.;

³ Gramatika e gjuhës shqipe 1, Tiranë, 2002, f. 61.

⁴ N. Gazulli, *Fjalorth i Ri i Gazullit*, Tiranë, 1941, f. 39.

ok: *majm-ok, shqil-ok* etj.;
onë: *pitig-onë, zez-onë* etj.;
ore: *bisht-ore, gjinat-ore, kungull-ore, kjumsht-ore, sumbull-ore* etj.;
shëm: *bylmye-shëm, druej-shëm, gjall-shëm, her-shëm, pikat-shëm, vuj-shëm* etj.;

zë: (prapashtesa zvogëluese) *hej-zë, shei-zë, shndri-zë, ushoj-zë* etj.

Një ndër prapashtesat e përdorura në fjalorth është edhe prapashtesa **-tar**, me të cilën janë ndërtuar disa fjalë si: *lavër-tar, leje-tar, shej-tar, zhurma-tar* etj., prapashtesë që mendoj se autorit mund t'i ketë shpëtuar pa u vënë re.

Përveç prejardhjes me parashtesim dhe prapashtesim, në fjalorin e Gazullit dallohen edhe një sërë fjalësh me mënyrë fjalëformimi, prejardhje parashteso-prapashtesore, të cilat janë lidhur me temën e fjalës nëpërmjet mënyrave të fjalëformimit me parashtesë+temë+prapashtesë, ose me përngjitje+prapashtesim⁵, që kërkojnë një studim më të zgjeruar. Disa nga këto fjalëformime janë:

<i>mbëkambëcit</i>	<i>mbë+kambë+cit;</i>
<i>ndërhundëzue</i>	<i>ndër+hundë+zue;</i>
<i>papërgiashëm</i>	<i>pa+për+gia+shëm;</i>
<i>përgojshëm</i>	<i>për+goj(ë)+shëm;</i>
<i>përmujshëm</i>	<i>për+mu(a)+shëm;</i>
<i>përmbishëm</i>	<i>për+mbi+shëm;</i>
<i>shmirëzue</i>	<i>sh+mirë+zue;</i>
<i>zdritshëm</i>	<i>z+drit(ë)+shëm.</i>

Çfarë roli luajnë fjalët e përbëra në fjalorth?

Ndër kompozitat e gjuhës sonë, që janë bërë produktive edhe si tema fjalëformuese, sidomos në shekullin e fundit të zhvillimit të gjuhës letrare, normës standard, janë edhe kompozitat ekzocentrike-mbiemra.

Mbiemrat e tipit bahu-vrihi përfaqësojnë një nga tipat më të pasur dhe produktivë të fjalëve të përbëra. Prof. A. Kostallari, thekson se: "...fjalë e përbërë ose kompozitë e mirëfilltë në gjuhën shqipe është ajo fjalë dygjymtyrëshe që formohet nga bashkimi i dy a më shumë temave në një fjalë të vetme leksiko-semantike, strukturalisht të mbyllur, e cila formësohet si një tërësi e pavarur fonetiko-morfologjike, ka kategoritë e veta potenciale fjalëformonjëse, zhvillohet semantikisht dhe kryen

⁵ *Gramatika e gjuhës shqipe, 1*, Tiranë, 2002, f. 68.

Veçoritë morfo-strukturore e fjalëformuese të leksikut të shqipes...

funksionet e veta sintaktike gjithnjë si një tërësi-fjalë, pavarësisht nga veçoritë leksiko-gramatikore të komponentëve të saj”⁶.

Në fjalorin shpjegues të Gazullit gjenden fjalë të përngjitura në llojin e kompozitës, si: *afërmendësh, berrejshëm, buzëvjerrë, dhambësutë, frysëkuqe, lulkuqi, lulshpërvjeltë, mjekërrdhizë, mollakuqi, mundbjerrun, skjeplugë, sygjarpën* etj.

Një numër i konsiderueshëm kompozitash ekzocentrike-mbiemërore, paraqiten në fjalor si determinative-përcaktuese, të cilat, disa prej tyre nuk janë zhveshur nga zanorja fundore e cila hyn në komponentët e parë në kompozim, si:

ashkëkuqe – që e ka ashkën të kuqe;
bjerraditas – që e çon ditën kot;
bollapjeshkë – që është e fortë dhe e bukur si pjeshkë;
buzëhollët – që ka shumë naze në të ngrënë;
dorërrudhët – që është i shtrënguar, koprrac;
ferrëkambëpatë – që shpejton me bi, -mandaferra;
grykëhollë – për antonomazinë -pushkën;
punërryeshëm – për atë që nuk i ecën puna etj.

Autori në fjalor jep ambivalencat e kompozitave dëshirore e pronësore me përmbajtje semantike edhe si dëshirore edhe si pronësore, si:

ballafyçkë: - me marrë një ballot, t’ajtnit prej së rrëxuemit;
fjalëmujshtëm: - I shtyn ndër fjalë, me fjalë të forta;
gopzi-zezë: gopqar-e: - njeri grykës. (që nuk ngopet nga asgjë);
ndeshëmirë, ogurmire: - ai që sjell e ndjell mirë (fjalë këto të pashpjeguara nga autori) etj.

Këto kompozita tregojnë jo vetëm vlerat leksikore, frazeologjike që ka fjalori por edhe vlerat e mëdha etnografike.

Nga e gjithë llojshmëria e fjalëve, në fjalorth nuk mungojnë edhe:

Fjalët me përngjitje, si: *gjithëkah, ndërdyzash, medigiasë, kudo, kendo* etj.;

⁶ A. Kostallari, *Kompozita ekzocentrike të shqipes si tema fjalëformuese*, në “Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe 1”, Tiranë, 1972, f. 95-104; *Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe, po aty*, f. 83.

Fjalët me nyjëzim, të cilat dalin me dallime semantike e morfematike në klasën e mbiemrave prejpjesorë me nyjë të përparme, duke e dalluar mbiemrin prejpjesor në rrafshin strukturor⁷, si: (i/e) *bam-e*, (i/e) *pamatun*, (i/e) *shkapërcyem*, (i/e) *brazhdë*, (i/e) *dryllët*, (i/e) *përmbarrshëm*, (i/e) *bylmyeshëm*, (i/e) *përgiashëm* etj.

Edhe ndërtimet me **konversion**, si mënyra e formimit të një fjale të re, si pasojë e kalimit në një pjesë tjetër të ligjëratës për shkak të kushteve sintaksore të përdorimit, nuk mungojnë në fjalor. Ato dalin: si:

Ndajfolje: *cofdël* – për: *njeri i coftë*, (*cofdël i madh paska ken!*), *dhajnik-e* – për: *i dhënë pas njëj sendi*, (*dhajnik në hae*);

Emra: *giatoj-a* – për *njeri i giatë shtatit* (*erdhi giatoja*), *idhnakth-i* – për *bimë e idhët*, *edhe mollatartë e egër*, (*a erdhi idhnakthi?*) etj.

Emërtimet e pathjeshta në fjalor, formojnë një pasuri sa me vlera terminologjike aq edhe etnografike. Shumë prej këtyre njësive jepen dyshe, si emërtime të pathjeshta dhe si emërtime të thjeshta të cilat nuk kanë dalë nga përngjitja e sintagmës apo nga kompozimi togfjalshësor, por gjymtyra e dytë e kompozitës është mëvetësuar si njësi emërtuese e drejtpërdrejtë, ku fillimisht ka qenë me funksion atributiv, por tani ajo nënkupton klasën e llojit ku bën pjesë sendi a frymori që shënon dhe bëhet treguesi i tiparit mbi të cilin ngrihet emërtimi, si:

dy-velçe

dardhë zemëroke

fik hindi

groshë rrille

kungullorja

mollaftue

kulloshtër

dash bacan, dash gican, dash sharan etj.

lopë bajë, lopë sykëm, lopë laruke etj.

BIBLIOGRAFI

Gazulli, N., *Fjalorth i Ri i Gazullit*, Tiranë, 1941.

Gramatika e gjuhës shqipe 1. Tiranë, 2002.

⁷ V. Memisha, *Dukuri semantike gjatë formimit të mbiemrave prejpjesorë*, Gjirokastër, 1999, f. 1-17.

Veçoritë morfo-strukture e fjalëformuese të leksikut të shqipes...

Kostallari, A., *Kompozita ekzcentrike të shqipes si tema fjalëformuese*, në “Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe 1”, Tiranë, 1972; *Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe, po aty*.

Memisha, V., *Dukuri semantike gjatë formimit të mbiemrave prejpjesorë*, Gjirokastrë, 1999.

Pepa, S., *Dom Nikollë Gazulli dhe vepra e tij leksikografike*, “Studime filologjike”, nr. 3-4, 1999.